

Përmbajtja e portofolit të kualifikimit

Portofoli i çdo mësuesi të kulturës profesionale, kandidat për çfarëdo kategori kualifikimi, përbëhet nga dy pjesë:

1. Pjesa me të dhënat personale;
2. Pjesa me përmbajtje profesionale;

I gjithë dokumentacioni i portofolit të kualifikimit përgatitet nga kandidati në format elektronik (pdf) dhe dërgohet me e-mail në adresën info.kualifikimi@akafp.gov.al dhe brenda afatit të përcaktuar nga AKAFPK.

Pjesa e portofolit me të dhënat personale të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara):

1. Jetëshkrimin në gjuhën shqipe, sipas formatit të Europass (Shtojca I).
2. Certifikatat e trajnimeve të akredituara të kryera, me kreditet e fituara (të paktën 5 kredite për kategoritë "Mësues i kualifikuar" dhe "Mësues specialist", si dhe sipas nenit 15, pika 3 duhet të paktën 8 kredite për kategorinë "Mësues mjeshtër").
3. Certifikatat e trajnimeve të tjera, që lidhen me mësuesin ose profesionin, të kryera gjatë periudhës së kualifikimit (nëse ka).
4. Vërtetime që tregojnë se kandidati është bashkëpunëtor (specialist i jashtëm me kontratë) i AKAFPK (nëse është).
5. Dëshmitë e titujve/gradave shkencore të fituara (nëse ka).
6. Vërtetimin, nëse ka kryer, në periudhën e dy viteve të fundit, të paktën 3 (tre) ditë stazh (praktike) në fushën profesionale përkatëse, në një institucion publik apo biznes privat. Vërtetimi duhet të jetë i vërtetuar dhe i firmosur nga drejtori i ofruesit dhe nga përfaqësuesi i institucionit/biznesit.
7. Dëshmi të zotërimit të gjuhëve të huaja (nëse ka);

Pjesa me përmbajtje profesionale e portofolit të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara), ku evidentohet edhe emri e mbiemri i kandidatit:

1. Planin e mësimit të një lënde teorike profesionale ose të një moduli të praktikës profesionale, që e jep mësimit.
2. Plan-ditarin e një seance mësimore teorike, bazuar në mësuesin, me prezencë fizike dhe atë online, ose plan-ditarin e një seance mësimore praktike me prezencë fizike;
3. Formulimin e një objektiwi mësimor specifik, teorik ose praktik.
4. Një instrument për vlerësimin e njohurive ose shprehive të nxënësve apo kursantëve (test teorik me të paktën 5 njësi testi të ndryshme ose listë kontrolli për shprehje praktike me të paktën 5 kritere vlerësimi);
5. Një material mësimor për nxënësit/kursantët, për një çështje teorike (një faqe A4) ose një udhëzues pune për një aftësi praktike.
6. Një prezantim (në PowerPoint) për një çështje teorike ose praktike (jo më pak se 3 slajde).

Dokumentet e listuar më lart dhe të përcaktuara në nenin 5, pika 3 dhe 4 të Udhëzimit 21, dt.27.6.2022, janë dokumente të detyrueshme, mungesa e të paktën njërit prej tyre e përjashton kandidatin nga procedura e mëtejshme e kualifikimit.